



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) dhe nenit 51.1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja (d), dhe të nenit 44, paragrafi 44.1 shkronja (a) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, si dhe nenit 4 të Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-273423, dt.9.12.2014, Kuvendi i Kryeqytetit në mbledhjen e mbajtur më 15.7.2026, merr këtë:

**V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN
E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

1. MIRATOHET ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit, nr. 01-020/04-31224/26, i datës 2.3.2026, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Ndryshohet pika II e Vendimit të lartcekur, ashtu që anëtarja e deritanishme, znj. Jeta Rafuna-Hasani, zëvendësohet me anëtarin e re, znj. Donjeta Dragusha, z. Leutrim Retkoceri zëvendësohet me z.Plator Gërdovci dhe z. Agron Canolli zëvendësohet me z. Muhamet Selmani.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/05-106219/26, më 16.7.2026

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

